

Ndërgjegjësimi dhe edukimi mbi rrezikun e ekstremizmit të dhunshëm në shkollë.


Projekti: Parandalimi dhe Riintegrimi i Sigurt: Qasje Holistike dhe Qëndrueshmëri ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm

Dr. Adriana QAFA


External Expert





- 
- Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive tuaja mbi konceptet kyçe të terrorizmit, të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm,
 - Metodologjia e trajnimit është e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar dhe raste praktike nga pjesëmarrësit.

Terrorizmi, nga rrënjët e lashta tek transformimi në një mjet radikal për të imponuar ndryshime politike



Por...Çfarë është ajo, që e bën dikë të etiketohet terrorist?



Në se dikush bëhet ekstremist, apo terrorist, ka pak të bëjë me tiparet e personalitetit të tij.



Gjatë Terrorit, Robespieri e përshkroi terrorizmin si një formë virtuoze të dhunës, që do të përdorej nga shteti i ri revolucionar demokratik, kundër armiqve të tij të brendshëm.



- ***Terrorizmi modern***, që nënkupton përdorimin sistematik të dhunës kundër shtetit, dhe jo nga shteti, u shfaq në Evropë në vitet 1870.
- Megjithëse terrorizmi modern, pasoi lindjen e politikës moderne dhe të masmedias, dhuna terroriste është përdorur si një taktikë politike që nga kohërat e lashta.



**Zelotët hebrej dhe
Asasinët islamikë,
ishin terroristët e
lashtë**



**Ata e përdorën dhunën,
për të komunikuar
mesazhet e lirisë nga
opozita, dhe rezistenca
ndaj nënshtrimit.**



Terrorizmi konsiston në kryerjen e një krimi nga një individ, një grup apo nga një shtet.

Terrorizëm është dhunë e paramenduar ndaj masës jo luftuese me qëllim ndikimin e opinionit publik për të arritur më pas në goditjen e objektivave me natyrë politike, ushtarake apo ideologjike. Këtu marrin kuptimet e tyre dhe fjalët terrorist dhe terrorizoj.

Kuptimi i ekstremizmit të dhunshëm

- Terrorizmi përdoret për të ngjallur tek njerëzit një ndjenjë frike e cila në shumë raste është shumë më e madhe se pasojat e vërteta të aktit. Këto akte kanë dy shënjestra, popullsinë ose dikasteret e rëndësishme të një shteti.
- Shkaqet e terrorizmit janë politike, për destabilizimin e një shoqërie por *edhe për hakmarrje*.
- Qëllime të ndryshme kanë çuar në themelimin e organizatave të ndryshme të cilat më pas nëpërmjet mesazheve të tyre me karakter politik ose fetar ngjallin frikë dhe panik në radhët e popullsisë.
- Shumë ide politike janë instrumentalizuar nga organizata terroriste për të justifikuar veprimet e tyre.
- Grupe terroriste eksitojnë në çdo ideologji.

Fjala franceze *terrorisme* që do të thotë "**frikësoj**".
I referohej në mënyrë specifike terrorizmit shtetëror



Jakobinët e përdorën këtë precedent, kur vendosën një regjim terrori gjatë Revolucionit Francez.



Edhe pse "terrorizmi" fillimisht i referohej akteve të kryera nga një qeveri, ajo zakonisht i referohet vrasjes së njerëzve të pafajshëm për qëllime politike në mënyrë të tillë që të krijojë një spektakël mediatik frike, terrori.

- Në nëntor 2004, një raport i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara e përshkronte terrorizmin si **çdo akt, "që ka për qëllim të shkaktojë vdekje ose lëndime të rënda trupore ndaj civilëve apo jo luftëtarëve me qëllim të frikësimit të popullates..**
- *apo për ti imponuar një qeverie a një organizate ndërkombëtare, për të bërë ose për të mos bërë ndonjë akt".*


Ekstremizëm




"ekstremizëm" do të thotë "besimi dhe mbështetja për idetë që janë shumë larg nga ajo që shumica e njerëzve i konsiderojnë të sakta ose të arsyeshme".

"ekstremizmi" i referohet qëndrimeve ose sjelljeve që konsiderohen jashtë normës.

- Kuptimi më i zakonshëm i termit që përdoret është se ai u referohet besimeve dhe veprimeve të njerëzve që mbështesin ose përdorin dhunën për të arritur **qëllime ideologjike, fetare ose politike.**
- Kjo përfshin terrorizmin dhe forma të tjera të dhunës së motivuar politikisht dhe sektare. Në mënyrë tipike, "**ekstremizmi i dhunshëm**" identifikon gjithashtu një armik ose armiq, të cilët janë **objekt i urrejtjes dhe dhunës.**

- 
- **Ekstremizmi i dhunshëm cilësohet siuate kur:**
 - ❖ Individit nuk pranon pikëpamje të ndryshme nga të vetat.
 - ❖ Kur mendon se pikëpamjet e veta janë të veçanta,
 - ❖ Kur nuk pranon mundësinë e të ndryshmes duke tentuar ti imponojë mendimet e veta të tjerëve, nëse është e nevojshme edhe përmes dhunës.
 - Asnjë shoqëri apo komunitet nuk është imun ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe pikëpamjet e tij mund të shfaqen kudo.



Terrorizmi ka të bëjë me mohimin e demokracisë dhe të të drejtave të njeriut

Thelbi konceptual i ekstremizmit të dhunshëm është se ai është një mjet i motivuar ideologjikisht për përdorimin e dhunës, i bazuar zakonisht në teori konspirative.

"Terrorizmi" i referohet një strategjie të veçantë të miratuar për të arritur një qëllim politik, i cili është në veçanti krijimi dhe shfrytëzimi i qëllimshëm i frikës.

Kuptimi i ekstremizmit të dhunshëm mund të përkufizohet në mënyra të ndryshme në varësi të rrethanave. Në kontekste të caktuara, mund të nënkuptojë thjesht "të duash të shkaktosh ndryshime politike".


- **Radikalizimi** - është shumë i debatuar kur përdoret në kontekstin e ekstremizmit të dhunshëm. Shqetësimi është se përdorimi i termit mund të shërbejë për të justifikuar kufizimet e lirisë së fjalës.
- **Qëndrueshmëria** - "rezistenca" i referohet aftësisë për t'i rezistuar - ose për të mos iu përmbajtur - pikëpamjeve dhe opinioneve që portretizojnë botën në të vërteta ekskluzive, të cilat legjitimojnë urrejtjen dhe përdorimin e dhunës.
- **Ndërtimi i qëndrueshmërisë midis studentëve dhe të rinjve** është një nga masat kryesore që mund të zbatohet nga sektori i arsimit për të parandaluar përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm.

- **SI MUND TA KUPTOJ SE CILI ËSHTË NJË EKSTREMIST I DHUNSHËM OSE TERRORIST?**
- **Ajo që ju do të kuptoni ndryshon në varësi të moshës, temperamentit dhe personalitetit tuaj. Nuk ka “asnjë masë që iu përshtatet të gjithëve». Në moshë të caktuar, apo në nxënës të caktuar, këto fenomene kuptohen ndryshe.**
- **Për fëmijët e vegjël, për shembull:** “Ekstremizmi është kur dikush bën diçka të keqe dhe mendon se ka një arsye të dobishme për ta bërë atë. Por përdor mënyra më paqësore për të përçuar mesazhin tek ata.”
- **Nëse ju jeni në një moshë më të madhe,** ju mund të kuptoni një koncept më të ndërlikuar, por ju do t’i kuptoni shkaqet dhe motivet e këtyre fenomeneve bazuar në aftësitë tuaja në varësi të edukimit dhe moshës tuaj



Mësuesi dhe shkolla aktorët kryesorë në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

- **Roli i Mësuesit në Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm.**
- **Krijimi i një fryme pozitive në klasë, zvogëlon mundësinë e sjelljeve antishoqërore dhe te dhunshme.**
- **Shkolla ka një rol shumë të rëndësishëm në përballimin e problematikave dhe sfidave të sotme shoqërore.**
- **Shkolla duhet të identifikojë, ndër të tjera, faktorët që krijojnë kushtet që çenojnë vlerat demokratike dhe sigurinë e fëmijëve.**
- **Shkolla duhet të vlerësojë diversitetin kulturor, botëkuptimor, shoqëror, etnik etj., por duke u kujdesur që këto vlera, të mos krijojnë kushte për dukuri ekstremiste.**

- 
- **Nëse stafi arsimor dhe mbështetës, gjatë procesit mësimor-educativ, vëren disa shenja problematike ai/ajo duhet të zbatojë procedurat e ndërhyrjes.**
 - **Veprimi i duhur dhe në kohë të duhur është më se i nevojshëm për trajtimin e rasteve në mënyrë të dobishme, para se ato të përshkallëzohen drejt ekstremizmit.**
 - **Sa më i hershëm të jetë identifikimi i rasteve problematike, aq më i lehtë do të jetë menaxhimi i tyre .**



Bashkëpunimi Mësues – Prind

- **Nëse ju si mësues jeni të shqetësuar** për një nxënës, i cili mund të jete i radikalizuar, ju duhet të ndiqni standardet e shkollës, si për çështje të tjera problematike.
- **Së bashku mund të diskutoni** shqetësimin tuaj me prindërit e nxënësit.
- **Në rast se e shihni të nevojëshme** duhet të kërkoni ndihmën e bordit të prindërve ku mund të diskutoni rreth situatës, duke ofruar zgjidhje të mundshme



Janë një sërë faktorësh "shtytës" dhe "tërheqës" që nxisin ekstremizmin e dhunshëm, të cilët nuk duhen neglizhuar nga stafi arsimor i shkollës.

► **Faktorët Individualë...** këtu përfshihen të gjitha pakënaqësitë dhe emocionet individuale

- 1) Tjetërsimi dhe përjashtimi
- 2) Zemërimi dhe zhgënjimi
- 3) Përjetimi i një ndjenje të fortë padrejtësie mbi atë që ndodh përreth
- 4) Ndjenja e poshtërit
- 5) Tendencë për të keqinterpretuar situatën
- 6) Teoritë konspirative
- 7) Ndjenja e viktimizimit
- 8) Dobësi personale
- 9) Elementët kundërkulturor



► **Faktorët Socialë:** këtu përfshihen faktorë të tillë si:

- 1) Përrjashtimi Social
- 2) Margjinalizimi dhe diskriminimi (i vërtetë ose i perceptuar)
- 3) Lëvizshmëria e kufizuar
- 4) Niveli i arsimimit
- 5) Përfshirja në tregun e punës
- 6) Zhvendosja nga një vend tek një vend tjetër
- 7) Kriminaliteti
- 8) Mungesa e kohëzimit social dhe vetëpërrjashtimi

➤ **Faktorët politikë këtu përfshihen faktorët NE dhe ATA**

- 1) Individi portretizon forcën politike dominuese si pushtuese të identitetit, duke përjashtuar kështu ndjenja të forta padrejtësie dhe zemërimi që e shtyn ta perceptojë botën si të ndarë në **2**, njëra anë kërkon mbrojtje/ sakrificë për mbijetesë dhe ana tjetër e ngarkuar me stereotipa dhe praragjykime negative.

➤ **Faktorët ideologjikë/fetarë:**

- 1) Këtu përfshihen rrëfimet historike që konsiderohen të shenjta
- 2) Këtu kemi shembuj pa fund për krime të kryera në emër të krishterimit apo islamizmit duke predikuar mbrojtjen e besimit nga mëkati i vdekshëm dhe imoraliteti.

❑ **Krizat kulturore dhe të identitetit** ky grup faktorësh ka lidhje me marginalizimin kulturor, i cili çon në tjetërsim të perceptuar dhe një ndjenjë të fortë mungesë përkatësie ndaj vendlindjes apo shoqërisë në të cilën individi jeton .

❑ **Traumat dhe mekanizma të tjerë nxitës...këtu** përfshihen trauma psikologjike të përjetuara në fëmijëri që manifestohen tek individi në formë të çrregullimit post-traumatic ku përfshihen edhe problem të tjera të shëndetit mendor.

➤ **Faktorë të tjerë janë edhe :**

➤ **Dinamika e grupit** ..ku normat e grupit janë burim i fuqishëm influence për anëtarët e grupeve specifike, ku individët mund të zgjedhin një rrugë që nuk e kishin konsideruar më parë pikërisht për shkak të ndikimit të dinamikës së grupit.



1) Ekstremizmi i dhunshëm mund të shfaqet lehtësisht në grupe të bashkuara nën një ideologjie të përbashkët.

➤ **Mediat Sociale...**

1) Media sociale është platform më e përshtatshme për shpërndarjen e informacionit në shpërndarjen e informacionit në formatin e dëshiruar në mënyrën më të shpejtë të mundshme.



2) Mediat sociale shumëfishojnë lehtësisht gjuhën e urrejtjes dhe riorganizojnë përhapjen e informacionit të rremë ku nëpërmjet celularëve apo faqeve kanale të ndryshme ndërhyjnë në emocionet psikologjike dhe bashkëpunimin në grupet e ekstremizmit të dhunshëm.

- **Në arsim, kemi faktorë** që nënkupton zhvillimin e kapacitetit të nxënësve për të menduar në mënyrë kritike, për të mësuar me anë të kërkimit (të mësuarit e bazuar në hetim) dhe për të verifikuar faktet në mënyrë që ata të mos bien pre e pikëpamjeve të thjeshta dhe njëdimensionale të botës të përhapura nga grupet e dhunshme ekstremiste.
- **Arsimi nuk mund të parandalojë** një individ nga kryerja e një akti të dhunshëm në emër të një ideologjie ekstremiste të dhunshme, por ofrimi i arsimit përkatës me cilësi të mirë mund të ndihmojë në krijimin e kushteve që e bëjnë të vështirë përhapjen e ideologjive dhe akteve të dhunshme ekstremiste.

- 
- 
- **Politikat arsimore** mund të sigurojnë që vendet e mësimi të mos bëhen një terren pjellor për ekstremizëm të dhunshëm.
 - **Mund të sigurojnë që përmbajtja arsimore dhe qasjet e mësimdhënies/të nxënit të zhvillojnë qëndrueshmërinë e nxënësve ndaj ekstremizmit të dhunshëm.**
 - Prandaj, *roli i arsimit nuk është të përgjojë ekstremistët e dhunshëm ose të identifikojë individë që potencialisht mund të bëhen ekstremistë të dhunshëm*, por të krijojë kushtet që ndërtojnë mbrojtjen, brenda nxënësve, kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe forcojnë angazhimin e tyre ndaj jodhunës dhe paqes.

- *“Arsimi, zhvillimi i aftësive dhe punësimi”* përbëjnë një nga shtatë fushat e veprimit të identifikuara në Planin e Veprimit të OKB-së.
- **“Si pjesë e luftës kundër varfërisë dhe marginalizimit social, ne duhet të sigurojmë që çdo fëmijë të marrë një arsim cilësor që e pajis atë për gjithë jetën, siç përcaktohet në të drejtën për arsim.**
- **Arsimi duhet të përfshijë mësimdhënien** për respektimin e të drejtave të njeriut dhe diversitetin, nxitjen e të menduarit kritik, promovimin e shkrim-leximit mediatic dhe dixhital, dhe zhvillimin e aftësive të sjelljes dhe socio-emocionale që mund të kontribuojnë në bashkëjetesën dhe tolerancën paqësore.

- **1 - Investoni në arsim**, veçanërisht në edukimin e fëmijërisë së hershme, nga mosha 3 deri në 8 vjeç, për të siguruar që të gjithë fëmijët të kenë akses në arsim gjithëpërfshirës dhe me cilësi të lartë, duke marrë parasysh mjedise të ndryshme sociale dhe kulturore;
- **2 - Zbatimi i programuesve të edukimit** që promovojnë “qytetarësinë globale”, aftësitë e buta, të menduarit kritik dhe shkrim-leximin dixhital, dhe eksplorojnë mjetet e futjes së edukimit qytetar në kurrikulat shkollore, tekstet shkollore dhe materialet mësimore. Ndërtimi i kapaciteteve të mësuesve dhe edukatorëve për të mbështetur këtë axhendë;
- **3 - Sigurimi i arsimit fillor gjithëpërfshirës përmes arsimit terciar**, duke përfshirë arsimin teknik dhe profesional, dhe mentorimin për të gjithë njerëzit e cenueshëm, duke përfshirë të zhvendosurit, duke përdorur teknologjinë online dhe cellular.

- 
- 
- **Bashkëpunimi dhe mbështetja në partneritet**, që përputhet me kontekstin e këtyre masave, në funksion të rritjes së efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së tyre.
 - **Angazhimi i komuniteteve** do të jetë, gjithashtu, thelbësor për forcimin e besimit të publikut dhe mbështetjes për politikat ku kryesisht në shënjestër do të jenë të rinjtë në zonat më problematike dhe suksesi i tyre do të varet nga përfshirja e të gjitha segmenteve të shoqërisë.

- **Metodat komunitare** të ofrimit të shërbimeve publike do të kanalizohen për t'iu drejtuar komuniteteve më të rrezikuara.
- **Nxitja e mendimit kritik**, pjesëmarrjes civile dhe inkurajimi i vlerave të tolerancës përmes arsimit
- **Nisma “Shkolla si qendër komunitare, një shkollë miqësore për të gjithë”,** që është futur tashmë në sistemin arsimor shqiptar, do të zgjerohet për të mbështetur përpjekjet e strategjisë.
- **Projekti “Shkolla si qendër komunitare”** mund të shndërrohet në një instrument politik afatgjatë të fuqishëm, që i kundërpërgjigjet kërcënimit të ekstremizmit të dhunshëm, duke ofruar shërbime këshillimi e duke vepruar si hallkë qendrore në konceptimin e programeve parandaluese.

- **Mësuesit janë punonjës të rëndësishëm të vijës së parë, të cilët shërbejnë si ndërlidhës brenda komuniteteve. Për rrjedhojë, aftësia e tyre për të shquar dhe për t’iu kundërpërgjigjur radikalizimit e, përfundimisht, për ta parandaluar atë, duhet forcuar.**
- **Sipas Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar (2014–2020), Ministria e Arsimit dhe Sportit ka në plan që, gjatë viteve pasardhëse të zgjerojë rrjetin “Shkolla si qendër komunitare”.**

Shtrirja dhe angazhimi në komunitet

- Kjo masë do të përmbajë veprimet në vijim:
- a) Zgjerimin e rrjetit “Shkolla si qendër komunitare” për t’u shtrirë në zonat problematike.
- b) Fuqizimin dhe trajnimin e mësuesve për të dalluar e për të reaguar ndaj shenjave të radikalizimit.
- c) Rritjen e mbështetjes për përpjekjet shkollore e jashtëshkollore në shkollat e synuara, për të parandaluar radikalizmin, përfshi edukimin civil e fetar, nismat artistike dhe sportive, klubet e debatit dhe veprimtari të ngjashme që rritin qëndresën.
- **Trajnimi i nxitësve social-ekonomik të radikalizmit përmes arsimit dhe formimit profesional dhe shërbimeve të punësimit.**
- a) Zgjerimi i shërbimeve kombëtare të punësimit dhe mbështetjes së tregut aktiv të punës për t’u shtrirë te grupet dhe individët më në rrezik.
- b) Ofrimi i formimit profesional në zonat problematike të përshtatur me nevojat e popullsisë lokale.
- c) Krijimi i nismave të formimit profesional dhe ndihmës për punësim në institucionet riedukuese, për të lehtësuar rehabilitimin dhe riintegrimin e autorëve të veprës së ekstremizmit të dhunshëm.
- d) Mbështetja e nismave publike dhe private që krijojnë mundësi punësimi, sipërmarrjes sociale dhe fuqizimit ekonomik të grave në zonat problematike të synuara.

- **3. Ndërtimi i besimit dhe besueshmërisë dhe rritja e sigurisë së komunitetit përmes policimit në komunitet.**
- a) Rritja e kapaciteteve të policimit në komunitet në zonat problematike të synuara.
- **4. Fuqizimi i shoqërisë civile për të ndërtuar qëndresën e komunitetit**
- a) Shpallja e thirrjeve për propozime për projekte që synojnë parandalimin e radikalizmit dhe rritjen e qëndresës së komunitetit kundrejt ekstremizmit të dhunshëm.
- **5. Propozimi i një strategjie krijuese dhe novatore si plotësuese e të gjithë punës sonë**
- a) Ngritja e një grupi pune për komunikimin, ku marim pjesë aktorë të ndryshëm si: zyrtarë të shtetit, akademikë, media dhe kompani teknologjike, shoqëria civile, komunitetet fetare dhe punonjësit e vijë së pare.
- b) Nxjerrja e udhëzimeve të komunikimit për partnerët lokalë, që do të zbatojnë nismat në terren.
- c) Ndërgjegjësim i vazhdueshëm përmes takimeve sistematike në komunitetet e synuara, duke mbledhur bashkëbiseduesit lokalë për të ofruar ide praktike për mënyrën e përballjes me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm në nivel lokal.

- **Ne duhet të vihem në krye të një nisme rajonale** kushtuar rritjes së kapaciteteve dhe bashkëpunimit kundër ekstremizmit të dhunshëm në shkollat tona, bazuar mbi përvojën, ekspertizën dhe veprimtarinë që zbatohet për këtë nismë.
- **Programet dhe aktivitetet që do të zhvillohen** në kuadrin e kësaj nisme rajonale do të përfshijnë ndarjen dhe zgjerimin e studimit lokal mbi shkaqet nxitëse të ekstremizmit të dhunshëm dhe masat për t'iu kundërvënë atij;
- **Trajnimitin e ligjzbatuesve për t'u angazhuar në komunitet** e për të identifikuar shenjat e hershme të radikalizmit dhe organizimin e fushatave të bashkërenduara publike në platformat e medias sociale e tradicionale për t'iu kundërvënë dhe për të ofruar alternativa kundrejt mesazhit të ekstremizmit të dhunshëm.

- **Qëllimet e Trajnimit Ekstremizmit të Dhunshëm:**
- **Forcimi i koordinimit**, bashkëpunimit dhe partneritetit në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, ndërmjet agjencive qeveritare, organizatave joqeveritare, sektorit privat, komuniteteve fetare dhe mediave, në identifikimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve efektive;
- **Inkurajimi i hulumtimit** vendor si mjet për të kuptuar kushtet, faktorët dhe shkaqet që nxisin radikalizimin që mund të kalojë në dhunë dhe qëndresën e komunitetit ndaj ekstremizmit të dhunshëm;
- **Forcimi i qëndresës** së komunitetit dhe zvogëlimi i tërheqjes ndaj radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet programeve dhe politikave të arsimit, punësimit dhe parandalimit nga policia në komunitet;
- **Ulja e ndikimit të propagandës** ekstremiste në rrjetet sociale dhe rekrutimit në internet, duke shfrytëzuar mediat sociale si kanale të komunikimit për të promovuar narrativa alternative dhe mesazhe pozitive.
- **Qendra Kunder Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE)** synon të bashkëpunojë me aktorët e sektorit publik dhe privat për të ruajtur dhe promovuar vlerat e tolerancës dhe harmonisë fetare, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sundimin e ligjit dhe demokracinë, si dhe ruajtjen e shoqërisë shqiptare nga ekstremizmi i dhunshëm.

Qëllimet e Trajnimit Ekstremizmit të Dhunshëm

- Mbështetje për fëmijët dhe të rinjtë e rikthyer nga zonat e konfliktit
- Riintegrimi social i fëmijëve dhe të rinjtë
- Fëmijët dhe rinjtë e rikthyer nga zonat e konfliktit kërkojnë kujdes dhe mbështetje të veçantë për t'u bërë anëtarë të veçantë për tu integruar si anëtarë konstruktivë të shoqërisë.
- Këta fëmijë kanë qënë të ekspozuar ndaj dhunës ekstreme dhe pas rikthimit mund të përballen me një refuzim dhe stigmatizim të ashpër brenda komuniteteve të tyre
- ***Riintegrimi social ka dy kompetente kyçe***
- 1- rehabiliteti individual i fëmijëve dhe nevojat e tyre specifike
- 2- rivendosja ose krijimi i lidhjes ndërmjet fëmijës dhe mjedisit social, ku këtu merren parasysh edhe nevojat e familjeve dhe komuniteteve.
- Fëmijët e rikthyer nga zonat e konfliktit mund të kenë pësuar edhe lëndime fizike ose të kenë vuajtur nga sëmundje akute ose konkrete të cilat mund ti kenë lënë të patrajtuara dhe këto kanë një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri.

- **Nga studimet e bëra deri tani me këta fëmijë** janë parë çrregullime të ndryshme të shëndetit mendor si: çrregullime të stresit post traumatic, depresionit, pagjumësisë, mënyrat e duhura për të ngrënë, për të fjetur, për tu përqëndruar dhe për të mësuar.
- **Nga studimet kanë treguar se edhe gjinia ka një ndikim** të rëndësishëm në reagimin ndaj ngjarjeve të dhunshme dhe në veçanti vajzat kanë shanset më të larta për të zhvilluar çrregullime të stresit post-traumatic i cili shoqërohet jo vetëm me ekspozim më të fortë ndaj ngjarjeve traumatike, por edhe me akses më të kufizuar ndaj trajnimit.
- **Aksesi në shërbime psiko-sociale është një pjesë e rëndësishme** e rehabilitimit dhe riintegritit të këtyre fëmijëve në shoqëri.
- **Rikthimi këtyre fëmijëve dhe të rinjve ju krijon një ndjenjë sigurie**, normalizimi në jetën e tyre të përditshme.
- **Ju mundëson ekspozimin ndaj kulturës së diversitetit** dhe rrit ndërveprimin më individë jashtë familjes.
- **Përpara se fëmija të rikthehet në mjediset shkollore, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve në bashkëpunim me stafin e shërbimit psiko-social të shkollës duhet të kryejnë një vlerësim rreziku dhe nevojash të fëmijës.**

- ***Normalizimi si parim udhëzues: Parimi kryesor,***
- Kemi të bëjmë me fëmijët dhe të rinjtë e rikthyer në mjediset arsimore, është ***rikthimi në normalitet*** sa më shpejt të jetë e mundur. Shkolla duhet të ofrojë një hapësirë të sigurt ku fëmija ose i riu të ndjehet e mbështetur i mbrojtur. Rreziku që është nxënësi të shihet si “ndryshe” duhet të minimizohet dhe të bëhen përpjekjet e duhura për të minimizuar vëmendjen ndaj tyre.
- ***Ballafaqimet me rreziqet e mundshme të lidhura me fëmijët apo të rinjtë e kthyer.***
- Për shkak të historisë së tyre dhe përvojave të hidhura personale mund të kenë shqetësime dhe këto kthehen në rreziqe për fëmijët e tjerë.
- Si ka qënë reagimi juaj, i kolegëve apo punonjësve social në shkollë, sa të ndërgjegjësuar jeni ju për keto lloj shqetësimesh si në sjellje ashtu edhe në veprimet e tyre në klasa, shoqëri.. *.shembuj..nga ju nëse keni hasur shqetësime të tilla*
- **Për të zhvilluar dhe përmirësuar personalitetin e këtyre fëmijëve shkolla, pra NE** mësu , psik, pun soc duhet ti inkurajojmë që të zhvillojnë ide dhe përgjegjësi, të mbështeten për tu bërë anëtarë pozitiv të komunitetit të shkollës për tu bërë të suksesshëm në rrugën e tyre të dijes.

- **Shkolla duhet t'i kushtojë një rëndësi të madhe progresit të këtyre fëmijëve**, një vëmendje e vazhdueshme në përmirësimin e tyre në çdo aspekt duke i motivuar dhe përfshirë në të gjitha aktivitetet dhe mjediset e shkollës.
- **Zhvillimi i një strukture mbështetëse për shkollën në bashkëpunim me partner të tjerë publikë dhe jopublike.**
- **Shkolla duhet të krijojë struktura mbështetëse me profesionistë** të fushave të ndryshme ku do të japin kontributin e tyre në organizimin, inkurajimin, integrimin në aktivitete dhe organizime të ndryshme brenda shkolle por edhe jashtë saj për ti kthyer këta fëmijë në normalitetin e shokëve në ambiente shkolle dhe jashtë.
- **Programe special për fëmijët e rikthyer...** duhen bërë më shumë programe për ti përfshirë këta fëmijë e të rinj në jetën reale të moshës së tyre, të ambientit në të cilën ata jetojnë, ku në raste të veçanta duhet bërë mbështetje specifike me lëndë të përshtatura për to.
- **Për të arritur rezultate të kënaqshme** me këtë kontingjent bëjmë mjaft trajnime dhe takime ku marrin por dhe shpërndajme eksperiencat tona për këtë çështje..
- Edhe në sot bëjmë një përmbledhje rreth ceshtjes se ekstremizmit dhe dhunes, për punën dhe trajnimet e stafit të shkollave për tju ardhur në ndihmë kësaj shtrese dhe për tu ndërgjegjësuar mbi rrethanat, traumat me të cilat fëmijët e kthyer kanë jetuar apo përjetuar ekstremizmin e dhunshëm për ti ndihmuar dhe mbështetur në çdo hap në **JETËN E TYRE Të RE.**

Terrorizmi, pra lufta e ditëve
tona, është përbindëshi i
vërtetë që duhet eliminuar.



Gino Strada



TOGETHER FOR LIFE



JU FALENDEROJ!

